

BULETINI IV

Fondacioni Kosovar për
Zhvillim të Karrierës - KCDF



FUSHËVEPRIMTARIA E ORGANIZATËS

Fondacioni Kosovar për Zhvillim të Karrierës (KCDF) është organizatë jofitimprurëse e themeluar për të avokuar dhe promovuar edukimin dhe orientimin në karrierë, ndërmarrësinë si dhe ndërlidhjen midis sistemit arsimor dhe tregut të punës në Republikën e Kosovës.

Qëllimi i organizatës është ofrimi i shërbimeve të ndërlidhura me edukimin dhe trajnimet, analizën e tregut të punës dhe punësimin. KCDF vepron si trup ndërmjetësuese dhe koordinuese midis organizatave publike dhe atyre joqeveritare të përfshira në këtë sektor, duke siguruar ndërveprim dhe bashkërendim të aktiviteteve.

Zhvillimi në karrierë
dhe ndërmarrësia


Aktivitetet, ngjarjet dhe
projektet e KCDF-së



Kosovo Career
Development Foundation

AFTËSIMI I STAFIT TË QENDRAVE TË KARRIERËS PËR PROJEKTIN “MBËSHTETJA E NXËNËSVE TË KLASAVE TË IX-TA PËR ZGJEDHJE TË INFORMUAR RRETH SHTEGUT TË KARRIERËS”

Në muajin Qershor, KCDF lansoi projektin “Mbështetja e nxënësve të klasave të IX-ta për zgjedhje të informuar rreth shtegut të karrierës”, mbështetur nga Projekti EYE - HELVETAS. Qëllimi i këtij projekti është lehtësimi i tranzicionit të nxënësve nga klasa e IX-të në shkollë të mesme të lartë, falë bashkëpunimit të ngushtë midis Qendrave të Karrierës dhe mësimeve të fushës Jeta dhe Puna në klasën e IX-të.



Për ta filluar këtë projekt, stafi i Qendrave të Karrierës mbajtën trajnimin pesë-ditor për Orientim në Karrierë, në të cilin u njoftuan me procesin pesë hapësh të këshillimit dhe orientimit për karrierë, përmes përdorimit të platformës Busulla.COM dhe veglave digjitale në dispozicion për ndërlidhje të SHMP-ve me sektorin privat.

PUNËTORIA ME QENDRAT E KARRIERËS PËR DORACAKUN E ORIENTIMIT NË KARRIERË (DOK)



Përveç këtij trajnimi, së fundmi KCDF organizoi punëtorinë me Qendrat e Karrierës lidhur me Doracakun për Orientim në Karrierë (DOK), ku pjesëmarrësit u njohën dhe aftësuan me një serë aktivitete për zbatim tek nxënësit e klasave të IX-ta, në bashkëpunim me mësuesit e këtyre shkollave, në mbështetje të edukimit dhe orientimit për karrierë.

STUDIMI BAROMETRI SHTETËROR I TË RINJVE 2021

Studimi Barometri Shtetëror i të Rinjve 2021 është realizuar përgjatë muajve Maj – Shtator, për të kuptuar planet dhe maturitetin profesional të të rinjve të cilat diplomuan nga shkollat e mesme të larta publike në Kosovë. Ky studim shpalos aspiratat, vetëbesimin për punësim dhe përvojën gjatë shkollimit të mesëm të lartë dhe gatishmërinë për tranzicion në punë apo arsimim të mëtejshëm.

Gjetjet nga ky studim janë reprezentative në nivel shtetëror dhe synojnë të informojnë institucionet vendimmarrëse dhe politik-bërëse për intervenimet e nevojshme dhe rëndësinë e përfshirjes së sektorit privat gjatë shkollimit të të rinjve.

KCDF këtë studim e ka realizuar në bashkëpunim me organizatën World Learning, me bazë në Uashington D.C., SHBA, në mbështetje të zhvillimit të shkathtësive tek të rinjtë, sipas nevojave të bizneseve.



Raportin e publikuar të studimit mund ta gjeni në link-un në vijim:

https://koscdf.org/wp-content/uploads/2021/10/Barometri-Shteteror-i-te-Rinjve_2021.pdf



NGRITJA DHE FUNKSIONALIZIMI I KËSHILLAVE LOKAL DHE KËSHILLIT REGJIONAL PËR ORIENTIM NË KARRIERË

Në kuadër të projektit “Zhvillimi i shërbimeve të orientimit në karrierë dhe ndërmarrësisë për të rinj”, të mbështetur nga organizata Solidar Suisse, u ngritën Këshillat Lokal për Orientim në Karrierë (KLOK) në komunën e Pejës, Deçanit, Klinës dhe Istogut. KLOK vepron si organ këshillues i nivelit lokal, në mënyrë që të koordinojë dhe këshillojë bartësit e arsimit publik të nivelit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në lidhje me zbatimin e planit për orientim në karrierë të nxënësve dhe punon në nxitjen e bashkëpunimit dhe ndërlidhjes së shkollave të mesme të ulëta me ato të mesme të larta.



Anëtarët e këshillit janë përfaqësues nga DKA, shkollat profesionale dhe shkollat e mesme të ulëta në secilën prej komunave të lartcekura. Përfaqësuesit e KLOK-ve takohen së paku një herë në 3 muaj dhe të njëjtit e përbëjnë Këshillin Regjional për Orientim në Karrierë (KROK). Në muajin Qershor 2021 janë mbajtur mbledhjet për funksionalizimin e këtyre mekanizmave, ndërsa në muajin Shtator 2021 janë diskutuar dhe identifikuar prioritetet, të cilat do të implementohen në vijim.

VAZHDIMI I PROJEKTIT “MBËSHTETJA E KLUBEVE TË KARRIERS NË SHKOLLAT E MESME TË ULËTA”

Mbështetja e 20 Klubeve të Karrierës në Shkollat Kampione po vazhdon përmes projektit “Mbështetja e Klubeve të Karrierës në Shkollat e Mesme të Ulëta”. Ky projekt është i mbështetur nga programi CDBE i GIZ. Në muajin Korrik 2021, KCDF mbajti takimin me drejtorët e shkollave dhe mësimeve mentor të klubeve, për të diskutuar rreth

arritjeve dhe aktiviteteve të zhvilluara dhe për të nxjerrë mësim dhe rekomandime për fazën e ardhshme të projektit. Nga përfaqësuesit e shkollës u paraqiten edhe disa propozime rreth aktiviteteve dhe trajnimeve të nevojshme për nxënës, të cilat pastaj janë adresuar në kuadër të projektit.

Identifikimi i fokus grupeve

Shtator - Tetor

Çka: Identifikimi i profesioneve të preferuara

Qëllimi: Mbështetja e nxënësve në përzgjedhjen e karrierës së ardhshme

Kush: KCDF

Për: Sekretariatit e Klubit të Karrierës

Organizimi i sesioneve me mysafir folës

Tetor - Nëntor

Çka: Takime virtuale me profesionistë të fushave të ndryshme

Qëllimi: Lehtësimi i tranzicionit nga klasa e IX-të në shkollë të mesme të lartë

Kush: KCDF

Për: Sekretariatit e Klubit të Karrierës

Nxënësve të Klubeve të Karrierës do t'u ofrohen trajnime të vazhdueshme për organizimin dhe udhëheqjen e aktiviteteve të parapara në Planin Dinamik të Punës.

ZHVILLIMI I MODULEVE TË TRAJNIMIT

Në mbështetje të 20 Klubeve të Karrierës në Shkollat e Kampione të Programit GIZ CDBE janë zhvilluar dy module të trajnimit, me qëllim që t'i ndihmojnë nxënësit të përmirësojnë dhe identifikojnë mënyrat e të mësuarit dhe zgjidhjes së konflikteve. Dy modulet e zhvilluara mund t'i shfletoni në ueb faqen e KCDF-së:

Mësimi efektiv dhe stilet e të mësuarit

<https://koscdf.org/mesimi-efektiv-dhe-stilet-e-te-mesuarit/>



Ndërmjetësimi dhe zgjidhja e Konflikteve



Ndërmjetësimi dhe zgjidhja e konflikteve


<https://koscdf.org/ndermjetesimi-dhe-zgjidhja-e-konflikteve/>

Gjatë javëve në vijim, KCDF do të ofrojë trajnim për nxënësit e Klubeve të Karrierës lidhur me këto dy tema të trajnimit.

ZHVILLIMI I DIALOGUT RRETH HENDEKUT TË SHKATHTËSIVE ME SEKTORIN PUBLIK, PRIVAT DHE SHOQËRINË CIVILE

Në bashkëpunim me World Learning, KCDF organizoi konferencën virtuale me temën "Zgjidhjet e sektorit privat për hendekun e shkathtësive në Kosovë", me përfaqësues të bizneseve nga industri të ndryshme, përfaqësues të institucioneve publike të arsimit, agjencive dhe ministrive përkatëse dhe shoqërisë civile.

Gjatë konferencës u prezantuan të gjeturat nga "Barometri Shtetëror i të Rinjve 2021" dhe u diskutua mbi sfidat me të cilat ballafaqohet sektori privat, qasja e ministrive dhe ofruesve publik të arsimit dhe roli i shoqatave të industrive dhe odave ekonomike. Gjatë kësaj konference u identifikuan një sërë mësimesh dhe rekomandime për palët e përfshira.



Për ta ndjekur konferencën e plotë, klikoni në link-un në vijim:
<https://fb.watch/8vJfKeQII-/>



PËRDITËSIMI I INSTITUCIONEVE PUBLIKE DHE PRIVATE TË ARSIMIT NË BUSULLA.COM

Në platformën Busulla.COM ndodhet moduli Shkollat / Universitetet në të cilin paraqiten të gjitha shkollat e mesme të larta dhe institucionet e arsimit të lartë, publike dhe private, të cilat operojnë në vendin tonë. Ky modul ka për qëllim lehtësimin e qasjes në informata mbi drejtimet, profilet, lëndët dhe mësimdhënësit dhe kushtet e regjistrimit, ashtu që palët e interesit (siç janë nxënësit, prindërit, mësimdhënësit, etj.) të mund të marrin informata të sakta dhe të përditësuara kurdo dhe kudo, përmes kyçjes në platformë.



The screenshot displays the Busulla.COM website interface. At the top, there is a navigation bar with the logo 'BUSÛLLA' and a language dropdown set to 'SQ'. The main menu includes 'Testet e karrierës', 'Profesionet', 'Shkollat/Universitetet', 'Puna dhe praktika', and 'Këshilltari'. A 'Kyçu' button is located in the top right corner. The main content area features a dark background with mathematical equations and a grid of four white buttons with icons and text:

- Shkollat e mesme të larta
- Universitetet/Kolegjet
- Qendrat për aftësim profesional
- Qendrat trajnuese

At the bottom of the screenshot, a dark blue banner contains the following text:

Me qëllim të mbështetjes së të gjithë të rinjve dhe të rejave për vendimmarrje të mirinformuar rreth institucioneve arsimore, edhe këtë vit KCDF ka bërë aktualizimin e të dhënave të të gjithë këtyre ofruesve të arsimit publik dhe privat.

AMBASADORËT NËPËR SHKOLLAT E MESME TË LARTA

Njëri nga qëllimet thelbësore të organizatës tonë është fuqizimi i të rinjve përmes vendimmarrjes së duhur për karrierë, qasjes në mundësi për trajnime dhe shkollim, ofrimit të shkathtësive të duhura dhe mundësive për angazhim në tregun e punës. Me këtë synim, KCDF ka përzgjedhur nga një Ambasador në secilën shkollë të mesme të lartë, ashtu që ata të promovojnë shërbime të tilla, në kuadër të organizatës virtuale rinore **Bursisti.COM**.



Qëllimi i këtij organizimi të të rinjve është që të shkëmbejnë informata, të organizohen dhe të avokojnë rreth temave në interesin e tyre dhe të bashkojnë fuqinë e tyre blerëse (për pajisje edukativo-arsimore, trajnime, shkollim, etj.).

Disa nga nxënësit Ambasadorë janë angazhuar në punë praktike gjatë muajve të verës në organizatën tonë, duke u aftësuar në incizimin dhe montimin e videove. Si rezultat i punës së nxënësve janë realizuar 10 video të profesioneve të cilat së shpejti do të jenë publike në **Busulla.COM**.



SHTRIRJA E SHËRBIMEVE TË ORIENTIMIT PËR KARRIERË NË SHKOLLAT PUBLIKE SERBE

Shtrirja e shërbimeve të ofruara përmes platformës Busulla.COM në komunitetin Serb është duke vazhduar, përmes partneritetit me organizatat lokale Serbe. Gjatë muajve të fundit janë mbajtur takime të shumta koordinuese midis partnerit lokal Young Active Graçanica (YAG), përfaqësuesve të Projektit EYE dhe KCDF, në të cilat janë identifikuar zgjidhje dhe forma më inovative për ofrimin e shërbimeve tek nxënësit Serb.



Me qëllim të mbështetjes së partnerit lokal, janë zhvilluar trajnime për trajnerët e përzgjedhur nga YAG. Për të lejuar qasje sa më të madhe të të rinjve dhe të rejave serbe rreth orientimit për karrierë, KCDF dhe YAG janë duke implementuar aktivitete përmes qasjes formale (bashkëpunimit me mësimdhënës) dhe jo-formale (promovimit dhe shtrirjes së aktiviteteve drejtpërdrejt me nxënësit).

Rreth 40 mësimdhënës të shkollave të mesme të ulëta dhe të larta Serbe do të përfshihen në zbatimin e aktiviteteve deri në fund të vitit 2021.

ARRITJE DHE STATISTIKA RRETH ORGANIZATËS DHE PARTNERËVE TONË

Disa arritje dhe statistika mbresëlënëse rreth mbështetjes së shkollave për këshillim dhe orientim në karrierë janë:

- +425,000 përdorues të platformës zyrtare të MASHTI-t për orientim profesional, edukim dhe këshillim në karrierë, Busulla.COM.
- 16 Klube të Karrierës të ngritura nga ASSET në 16 gjimnaze, të cilat pranojnë edhe mbështetjen e KCDF për zhvillimin e aktiviteteve për orientim në karrierë.
- 10 Qendra të Karrierës të ngritura nga Projekti EYE – HELVETAS, stafi i të cilave vazhdimisht pranon mbështetje rreth orientimit për karrierë dhe partneritetit me biznese dhe me shkollat e mesme të ulëta
- 20 Klube të Karrierës të ngritura nga KCDF në mbështetje të GIZ CDBE në 20 shkolla të mesme të ulëta nëpër regjione të ndryshme të vendit.



- +2,000 nxënës nga klasat IX dhe XII të përfshirë në studime gjurmuese.
- +1,800 maturantë të përfshirë në studime për identifikimin e nevojave dhe planeve pas përfundimit të shkollës së mesme.
- 10 video të profesioneve të zhvilluara.
- +20 profesione të zhvilluara.
- +150 shkolla dhe kolegje / universitete publike dhe private të përditësuara në **Busulla.COM**.

FALEMINDERIT!



Informatat kontaktuese:

+383 (0) 44 507 575
info@koscdf.org

Rr. Fazli Balaj, Nr.31, Hyrja D 10000
Prishtinë, Republika e Kosovës

<https://koscdf.org/>
<https://www.facebook.com/KosovoCDF/>
<https://busulla.com/>



Kosovo Career
Development Foundation